MIDIS IMUNITETIT DHE PËRGJEGJËSISË POLITIKE: NJË ANALIZË FILOZOFIKE E IMUNITETIT PARLAMENTAR PËRMES JOHN RAWLS DHE ROBERTO ESPOSITO

Suela DINELLARI (IBRAIMLLARI)
Departamenti i Shkencave Sociale
Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
Universiteti "Fan S. Noli"
suelaibraimllari@yahoo.com

Florian KODRA
Departamenti i Shkencave Sociale
Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
Universiteti "Fan S. Noli"

Abstrakt

Imuniteti parlamentar përcaktohet si një institut themelor i së drejtës kushtetuese, i cili gjeneron një tension strukturor midis dy parimeve kryesore të shtetit të së drejtës: mbrojtjes së pavarësisë së mandatit legjislativ dhe llogaridhënies juridike e elektorale të përfaqësuesve publikë. Ky artikull analizon imunitetin parlamentar jo si një mekanizëm procedural, por si një problematikë e filozofisë të së drejtës dhe politike. Analiza gërsheton dy korniza teorike të dallueshme, por plotësuese: konceptin e John Rawls mbi legjitimitetin politik dhe paradigmën biopolitike të Roberto Espositos mbi dinamikën communitas-immunitas. Artikulli argumenton se imuniteti është i justifikueshëm normativisht vetëm kur funksionon si mbrojtje e kapaciteteve përfaqësuese dhe deliberative të parlamentit dhe jo si përjashtim personal nga përgjegjësia. Nga perspektiva e Rawlsit, çdo imunitet duhet të legjitimohet përmes arsyes publike dhe parimit të reciprocitetit. Ndërsa sipas Esposito-s, immunitas mbart një paradoks: ajo mbron institucionin nga detyrimet kolektive, por zgjerimi i tepërt i saj rrezikon të dëmtojë vetë communitas-in që synon të ruajë. Përmes analizës së neneve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe jurisprudencës evropiane, ky punim propozon kornizën e "imunitetit të përgjegjshëm", të bazuar në funksionalitet, proporcionalitet, transparencë dhe kontroll institucional.

Fjalë kyçe: *John Rawls; Roberto Esposito; communitas; auto-immunitas; përgjegjësi politke; shteti i së drejtës.*

BETWEEN IMMUNITY AND POLITICAL ACCOUNTABILITY: A PHILOSOPHICAL ANALYSIS OF PARLIAMENTARY IMMUNITY THROUGH JOHN RAWLS AND ROBERTO ESPOSITO

Abstract

Parliamentary immunity is defined as a fundamental institution of constitutional law that generates a structural tension between two core principles of the rule of law: the protection of the independence of the legislative mandate and the legal and electoral accountability of public representatives. This article analyzes parliamentary immunity not merely as a procedural mechanism, but as a problematic issue within the philosophy of law and political philosophy. The analysis intertwines two distinct yet complementary theoretical frameworks: John Rawls's concept of political legitimacy and Roberto Esposito's biopolitical paradigm of the communitas-immunitas dynamic. The article argues that immunity is normatively justifiable only when it functions to protect the representative and deliberative capacities of parliament, rather than serving as a personal exemption from liability. From a Rawlsian perspective, any form of immunity must be legitimized through public reason and the principle of reciprocity. Conversely, according to Esposito, immunitas embodies a paradox: it protects the institution from collective obligations, yet its excessive expansion risks undermining the very communitas it aims to preserve. Through an analysis of the articles of the Constitution of the Republic of Albania and european jurisprudence, this paper proposes the framework of "responsible immunity," grounded in functionality, proportionality, transparency, and institutional oversight.

Keywords: *John Rawls; Roberto Esposito; communitas; auto-immunitas; political accountability; rule of law.*

Hyrje

Në shtetet demokratike, pushteti politik nuk mund të konceptohet i shkëputur nga përgjegjësia. Teoritë politike të *demokracisë kushtetuese; si ato të Montesque dhe Ruso;* evidentojnë, se ata që ushtrojnë pushtet në emër të sovranit nuk janë mbi ligjin, por janë njëkohësisht subjekt dhe garantues të rendit ligjor. Nga kjo logjikë derivon një tension i veçantë që karakterizohet nga imuniteti parlamentar. Parimi i refleksivitetit normativ, siç thekson Gerald J. Postema *(2022, f. 19),* kërkon që ata që sundojnë përmes ligjit të jenë të nënshtruar ndaj tij në kuadër të një sistemi të llogaridhënies së

ndërsjellë, ku elita qeverisëse nuk përjashtohet nga përgjegjësia ligjore. Në të njëjtën linjë, sipas Habermas pushteti politik e nxjerr legjitimitetin e tij vetëm përmes një procedure demokratike që garanton barazinë e plotë të statusit ndërmjet përfaqësuesve dhe të përfaqësuarve, duke siguruar që autorët e ligjit të jenë njëkohësisht edhe adresuesit e tij të drejtpërdrejtë *(f. 110).*

Në planin historik dhe kushtetues, imuniteti parlamentar është krijuar për të mbrojtur përfaqësuesit e zgjedhur nga ndërhyrjet e jashtme që mund të cënojnë pavarësinë e mandatit të tyre dhe përmbushjen efektive të funksioneve të tij demokratike. Kështu, imuniteti ka për qëllim institucional mbrojtjen e autonomisë së funksionit parlamentar.

Problemi bëhet kompleks kur imuniteti nuk shihet vetëm si mbrojtje e funksionit, por si një përjashtim që mund të ndikojë në marrëdhënien ndërmjet qytetarit dhe përfaqësuesit të tij. Nëse qytetari është subjekt i ligjit, ndërsa përfaqësuesi politik gëzon një mbrojtje që në praktikë e vendos atë në një pozitë dukshëm të ndryshme, lind pyetja nëse kjo diferencë mund të justifikohet në mënyrë të barabartë përpara komunitetit politik.

Në këtë kuadër bëhet e rëndësishme perspektiva e John Rawlsit. Në veprën e tij *"Drejtësia si paanshmëri: një riformulim"* dhe *"Political Liberalism"*, ai vendos në qendër të filozofisë politike e të së drejtës, problemin e legjitimitetit të pushtetit politik, duke ngritur pyetjen se në çfarë kushtesh qytetarët mund të ushtrojnë në mënyrë legjitime pushtet politik mbi njëri-tjetrin *(Rawls, 2005, f. 137).* Përgjigjja e tij lidhet ngushtë me idenë e qytetarëve si persona të lirë dhe të barabartë, të cilët udhëhiqen nga arsyeja publike dhe "kriteri i reciprocitetit"**,** sipas të cilit ushtrimi i pushtetit politik është i justifikueshëm vetëm kur mbështetet në terma që qytetarët e tjerë mund t'i pranojnë në mënyrë të arsyeshme *(Rawls, 2005, f. 226-227, 446-447).* Në një drejtim tjetër teorik, Roberto Esposito ofron një instrument konceptual veçanërisht për analizën e imunitetit. Në filozofinë e tij politike, *communitas* dhe *immunitas* janë dy koncepte të lidhura etimologjikisht dhe ontologjikisht me rrënjën latine *munus (2010, f. 5-6).* Në këtë kuadër, "*communitas"* shpreh dimensionin e përbashkët, ku subjektet bashkohen përmes një detyrimi reciprok për të dhënë pa pritshmëri kthimi, ndërsa *immunitas* përfaqëson pikërisht anën e saj të përmbysur: ajo shpreh kushtin e përjashtimit të individit

apo të institucionit nga ky detyrim kolektiv *(Esposito, 2010, f. 6; 2011, f. 5)*

Në këtë kuptim, artikulli ngre pyetjen qendrore: Në çfarë kushtesh imuniteti parlamentar mund të konsiderohet një instrument legjitim i mbrojtjes së demokracisë dhe kur ai rrezikon të shndërrohet në privilegj që dobëson përgjegjësinë politike dhe barazinë përpara ligjit? Hipoteza e studimit është se legjitimiteti i imunitetit parlamentar nuk buron nga statusi personal i përfaqësueit, por nga funksioni kushtetues që imuniteti synon të mbrojë. Për këtë arsye, sa më e dobët të jetë lidhja ndërmjet imunitetit dhe ushtrimit konkret të mandatit, aq më e dobët bëhet edhe justifikimi i tij demokratik. Për verfifikimin e hipotezës, ky studim paraqet një qasje cilësore të kërkimit, që ndërthur filozofinë politike dhe filozofinë e së drejtës me aspektin normativ-kushtetues dhe juridik europian. Metoda kryesore e përdorur është analiza konceptuale dhe teorike, e ndërthurur me metodën krahasuese dhe analizën hermeneutike. Përmes hermeneutikës ligjore, bëhet interpretimi i neneve 73, 90, 103 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në rrafshin literal, ligjor dhe të së drejtës në kuadrin europian. Në mënyrë të veçantë, analiza mbështetet në dy korniza teorike: teoria e John Rawlsit dhe e Roberto Espositos. Metodologjia e përdorur synon të ndërtojë një kriter filozofik dhe normativ për vlerësimin e legjitimitetit, me rikonceptimin e një një nocioni të ri të definuar si *"imunitet i përgjegjshëm".*

1. Korniza teorike-konceptuale e imunitetit politik: mes liberalizmit të Rawlsit dhe biopolitikës së Espositos

Një nga premisat themelore të filozofisë së Rawlsit është ndërtimi i nocionit të drejtësisë mbi dy prinicipe: atë të lirive themelore të barabarta dhe principin e diferencës; duke zhvendosur kuptimin e drejtësisë si paanshmëri brenda kuadrit politik të ndërtimit të saj *(Rawls, 2001, f. 87-88).*

Ky përcaktim krijon konstruktet politike të tezës liberale dhe idesë së një demokracie kushtetuese e ndryshme nga ajo proceduriale. Rawlsi thotë se: *"Në një regjim kushtetues, ligjet dhe statutet duhet të përputhen me disa të drejta e liri themelore, si për shembull me ato që ngërthen principi i parë i drejtësisë. Faktikisht, ai ka një kushtetutë*

(jo medoemos të shkruar) më një deklaratë të të drejtave që specifikon liritë themelore dhe që interpretohet nga gjykata si kufi kushtetues ndaj ligjvënësit" (Rawls, 2001, f. 246). Kështu, përfaqëuesi politik në legjislativ ka një status të veçantë funksional, por kjo nuk do të thotë se ai ka një vlerë juridike ose morale më të madhe se qytetari që përfaqëson. Prandaj, një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i përgjegjësisë duhet të ketë një justifikim publik. Në këtë kontekst zhvillohet parimi i legjitimitetit të Rawlsit. Pushteti politik është legjitim kur ushtrohet në atë mënyrë që qytetarët e lirë dhe të barabartë mund t'a pranojnë në mënyrë të arsyeshme. *"Vlerat e drejtësisë dhe të arsyes publike shprehin bashkarisht idealin liberal sipas të cilit, përderisa pushteti politik është pushtet detyrues i qytetarëve si korpus kolektiv-pushtet ku çdonjëri ka një pjesë të barabartë me të tjerët- përdorimi i tij, të paktën kur fjala është për bazat kushtetuese dhe çështje themelore të drejtësisë, duhet të jetë vetëm i atillë që të mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme se do të ketë mbështetjen e krej qytetarëve"*- thotë Rawlsi *(Rawls, 2001, f. 315).* Në këtë perspektivë, pyetja: "Pse përfaqësuesi politik në legjislativ duhet të gëzojë imunitet?", nuk mund të marrë si përgjigje të mjaftueshme "sepse zotëron një funksion dhe pushtet të veçantë".

Arsyetimi politik nisur nga ideja e demokracisë kushtetuese mbështet mbi idenë e "doktrinës gjithëpërfshirëse" të Rawlsit. Sipas saj, qytetatërët janë të arsyeshëm e bashkëveprojnë duke besuar tek institucionet, të cilat iu krijojnë siguri dhe garantojnë liritë dhe të drejtat. Mbi këtë bazë të *modus vivendi*; përfaqësuesi i pushtetit politik duhet të gëzojë këtë mbrojtje sepse pa të mund të cenohet një funksion kushtetues i domosdoshëm për demokracinë dhe kjo mbrojtje është e kufizuar vetëm në masën e nevojshme për ruajtjen e këtij funksioni.Ky ndryshim është thelbësor pasi imuniteti justifikohet nga statusi dhe nga funksioni.

Në teorinë e Rawlsit vihet re edhe lidhja e legjitimitetit me kriterin e reciprocitetit. Pushteti politik përdoret në mënyrë legjitime në një shoqëri liberale kur përdoret në përputhje me një konceptim politik të drejtësisë. Megjithatë, sfida e stabilitetit mbetet. Legjitimiteti nënkupton se ligji mund të zbatohet edhe me detyrim. Por, Rawls mbështet tek stabiliteti shoqëror dhe një konsensus i mbivendosur. Në terma rawlsianë, çdo qytetar mbështet një konceptim politik të drejtësisë për arsye të brendshme të doktrinës së tij gjithëpërfshirëse.

Kështu, edhe përfaqësuesi në legjislativ, nuk mund të kërkojë një mbrojtje që nuk do të ishte në gjendje ta justifikonte për qytetarin që ai përfaqëson. Kjo nuk do të thotë se çdo qytetar duhet të ketë të njëjtin status procedural pasi funksionet janë të ndryshme. Por, dallimi duhet të jetë i arsyeshëm dhe funksional. Këtu mund të formulohet një parim i rëndësishëm: sa më e madhe të jetë distanca ndërmjet mbrojtjes së dhënë dhe funksionit parlamentar që ajo synon të mbrojë, aq më i dobët është justifikimi i saj në termat e reciprocitetit. Ky parim e vendos *përgjegjësinë në qendër të konceptit të imunitetit*. Si qytetar i angazhuar në aktivitete të caktuara politike, përfaqësuesi në legjislativ ka një detyrë qytetarie që të jetë në gjendje të justifikojë vendimet e tij për çështje politike themelore, duke iu referuar vetëm vlerave publike dhe standardeve publike. Ai është bartës i një të drejte të veçantë dhe i një detyrimi publik të shtuar.

Një tjetër perspektivë filozofiko-politike është ajo e Roberto Esposito. Pika e nisjes së analizës së tij është një kthim etimologjik tek fjala *communitas* (komuniteti politik): nga latinishtja *cum* dhe *munus* si një detyrim, dhuratë që duhet kthyer apo barrë e përbashkët (*Esposito, 1998/2010, f. 7).* Në këtë kuadër, *immunis* është i përjashtuar nga *munus*-i; pra përjashtim nga barra publike (*Esposito, 2002/2011, f. 5)*. Kështu, imuniteti është mbrojtje dhe përjashtim; dhe jo vetëm imunitet negativ. Një nivel i caktuar imuniteti është i domosdoshëm për ekzistencën e organizmave dhe institucioneve. Problemi lind kur mekanizmi mbrojtës bëhet aq i fuqishëm sa fillon të dëmtojë marrëdhënien që duhej të mbronte. Në kontekstin politik të parlamentarizmit lind pyetja: nëse përfaqësuesi i pushtetit politik përfaqëson komunitetin politik, deri në çfarë mase mund të përjashtohet ai nga detyrimet që lidhin me pjesën tjetër të komunitetit?

Imuniteti parlamentar synon të mbrojë përfaqësuesin për të mbrojtur komunitetin. Por, nëse imuniteti përdoret për të shmangur përgjegjësinë personale për veprime që nuk kanë lidhje me funksionin përfaqësues, atëherë ai fillon të veprojë kundër komunitetit. Sipas Espositos, mund të dallojmë dy forma: *imuniteti mbrojtës*, që mbron funksionin parlamentar nga ndërhyrjet e padrejta, dhe *imuniteti përjashtues*, që mbron individin nga përgjegjësia që normalisht do të duhej të zbatohej. I pari është i nevojshëm për demokracinë; i dyti rrezikon demokracinë *(Esposito, 2002/2011, f. 8–9).* Duke e zhvilluar

më tej perspektivën e Espositos, mund të thuhet se një sistem demokratik mund të krijojë mekanizma mbrojtës që, nëse tejkalojnë funksionin e tyre, mund të prodhojnë "*rrezikun autoimun" duke përdorur terminologjinë në termat e politikës moderne.* Mekanizmi fillon me një qëllim legjitim: mbrojtja e përfaqësuesit në parlament, mbrojtja e parlamentit si institucion e pushtet i pavarur dhe mbrojtja e demokracisë si sistem politik qeverisjeje. Por, mund të shndërrohet në mbrojtje mbrojtje të individit, dobësim të përgjegjësisë dhe rënie të besimit tek institucionet dhe të funksionit publik. Nëse qytetarët perceptojnë se ligji zbatohet në mënyrë të ndryshme për elitat politike, atëherë imuniteti humbet karakterin e tij funksional dhe shndërrohet në simbol të pabarazisë. Në veprën "*Immunità comune: Biopolitica all'epoca della pandemia", (Esposito, 2022)* dhe në "*Vitam instituere: Genealogia dell'istituzione"(*Esposito, 2023); Esposito e rimerr paradigmën imunitare në dritën e pandemisë, duke kërkuar një biopolitkë ku imuniteti nuk duhet kundërvënë së përbashkëtës dhe propozon një ontologji politike që i adreson institucionit rol qëndror. Ai argumenton se kategoritë themelore të modernitetit (sovraniteti, prona, liria) funksionojnë në një regjistër imunitar. E drejta vepron si pajisje imunitare, sepse menaxhon dhunën duke e brendësuar në trajtë të kontrolluar. Mbrojtja arrihet duke futur brenda trupit një sasi të kontrolluar të asaj që kërkron të mbrohet, pra negativitetit. Ky nuk është refuzim imuniteti pasi asnjë organizem biogjik apo politik, nuk mbijeton pa mekanizma mbrojtës. Qasja e Espositos ofron një përcaktim në gjenezë për të drejtën. Për këtë arsye lind nevoja të analizohen përplotësimet e teorive dhe dinamikat përjashtuese të tyre.

2. Rawlsit vs. Espositos mbi statusin e imunitetit dhe rreziku i "autoimunitetit"

Rawls dhe Esposito nisen nga premisa filozofike të ndryshme. Rawlsi kërkon të ndërtojë kushtet e një rendi politik të drejtë dhe legjitim për qytetarë të lirë dhe të barabartë, ndërsa Esposito analizon mënyrën në të cilën konceptet e komunitetit dhe imunitetit ndërtojnë marrëdhënien ndërmjet subjektit dhe të përbashkëtës. Megjithatë teoritë e tyre ofrojnë një tablo konvergjencash dhe divergjencash, përplotësuese për konceptin e imunitetit parlamentar dhe qasjen drejt

një koncepti të ri, atë të *"imunitetit të përgjegjshëm*". Nga analiza e dy teorive, mund të identifikojmë disa të përbashkëta. Rawls përmes strukturës themelore dhe Esposito përmes imunitetit; e vendosin institucionin në qendër të teorisë. Ata trajtojnë të njëjtin fenomen nga këndvështrime të ndryshme. Rawls kufizon pabarazitë me principin e dytë mbi drejtësinë dhe Esposito kërkon masën e imunizimit; duke parashikuar nevojën për kufizime. Së bashku, e lidhin mbrojtjen me të përbashkëtën; Rawlsi përmes reciprocitetit e transparencës - publikes dhe Esposito përmes munusit e komunitetit. Pavarësisht nga kjo qasje plotësuese, trajtimi i analizës së tyre krahasuese bën të dallohen edhe divergjencat e teorive. Rawls i përket një ontologjie individualiste racionale (pozita fillestare dhe veli i padijes), ndërsa Esposito përcakton një ontologji relacionale të të përbashkëtës. Metoda e Rawlsit është teori idealiste e kontraktuale, ajo e Espositos është gjenealogjike. Për Rawls, konflikti mund të rregullohet përmes konsensusit të mbivendosur; ndërsa për Esposito, konflikti është konstruktiv. Së fundi, ligji sipas Rawlsit është sistem publik rregullash, ndërsa sipas Espositos pajisje imunitare me rrezik të brendshëm.

Nga sa më sipër mund të ndërtohen tri teza që plotësojnë njëra tjetrën. Teza e parë mund të emërtohet si teza *normative- diagnostikuese,* ku Rawls tregon çfarë duhet të justifikohet e para kujt dhe Esposito simptomatologjinë e dështimit, domethënë si justifikimi kthehet në mbyllje.

Teza e dytë, *procedurale-relacionale*: publikja dhe reciprociteti i Rawlsit mbrojnë në kuadër ligjor, atë që Esposito e quan "të përbashkët". Detyrimi i *munus*-it përputhet heuristikisht me kushtet e drejta të bashkëpunimit dhe ndihmon për të kuptuar pse një përjashtim nuk mund të jetë thjesht privilegj.

Dhe teza e tretë *"parandaluese-terapeutike";* struktura themelore e Rawlsit *ex ante,* ka nevojë për rijustifikim të vazhdueshëm *(Esposito, 2020/2022; 2022/2023*). Në praktikë, çështja e imunitetit kërkon formulim të kujdesshëm kushtetues, afate, rishikim dhe kontroll periodik.

Mbi bazën e tezave të mësipërme ndërtohen themelet dhe kriteret e *"imunitetit të përgjegjëshëm"*, ku proporcionaliteti shërben si urë mes imunitetit dhe përgjegjësisë, rregullat normative vendosin para tyre nocionin e barazisë e imunitetit dhe përgjegjësia politike shihet si

kusht i legjitimitetit. Vendosur në dimensionet e etikës, imuniteti parlamentar duhet të shihet në raport me idenë e besimit institucional publik. Qytetarët "komuniteti" i delegon përfaqësuesit të tij në parlament, një pjesë të kompetencës së tij politike. Ky delegim krijon asimetri pushteti. Sa më i madh të jetë pushteti i deleguar aq më e madhe duhet të jetë përgjegjësia për mënyrën se si përdoret. Në këtë kontekst koncepti teorik i imunitetit duhet t'i përmbahet parimit të proporcionalitetit duke rritur mbrojtjen funksionale të përfaqësuesit në parlament, por jo duke ulur standardin e përgjegjësisë së tij publike. Imuniteti duhet të kuptohet si garanci institucionale e shoqëruar me përgjegjësi institucionale.

3. Nga kuadri teorik tek transpozimi ligjor dhe konfigurimi i nocionit të "*imunitetit të përgjegjshëm*"

Nga ndërthurja e teorisë së Rawlsit me teorinë e Espositos mund të propozohet një koncept i ri interpretues: *imuniteti i përgjegjshëm.*

Ky koncept duhet të bazohet në katër dimensione. Në *dimensionin e funksionalitetit,* imuniteti duhet të lidhet me funksionin kushtetues të deputetit. Së dyti, në *dimensionin e proporcionalitetit,* që do të thotë se mbrojtja duhet të jetë aq e gjerë sa është e nevojshme. Së treti, *dimensioni i përgjegjësisë,* sipas të cilit imuniteti nuk duhet të eliminojë mekanizmat e përgjegjësisë politike, etike dhe institucionale. Së fundi, *dimensioni i reciprocitetit,* ku mbrojtja duhet të jetë e justifikueshme përpara qytetarëve që janë subjekt i të njëjtit rend juridik.

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) konfirmon se imuniteti parlamentar përbën një normë kushtetuese legjitime që nuk bie ndesh me Konventën *(European Parliament (2015, f. 5-7).* Në këtë kuadër, standardi evropian nuk synon eliminimin e imunitetit, por racionalizimin dhe kufizimin e tij në funksion të mbrojtjes së demokracisë përfaqësuese (*Venice Commission (2014, f. 9).* Për t'iu përgjigjur sfidave të shtetit të së drejtës; si ligjshmëria, siguria juridike dhe barazia para ligjit *(Venice Commission, 2016, f. 11-24,)* Komisioni i Venecias ka ofruar udhëzime të qarta për heqjen e imuniteteve *(Venice Commission, 2014, f. 3).* Specifikisht për Shqipërinë, rekomandimet e këtij organizmi janë fokusuar në kufizimin e imunitetit ndaj veprave

korruptive *(Venice Commission, 2006, f. 4-7)*, ndryshimet kushtetuese në drejtësi *(Venice Commission, 2016b, f. 12)* dhe vetingun e politikanëve *(Venice Commission, 2018, f. 9)*. Ky reformim mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme edhe nga Komisioni Evropian *(2025, f. 14–16)*, i cili e kushtëzon ecurinë e procesit të anëtarësimit me luftën ndaj korrupsionit dhe forcimin e llogaridhënies institucionale.

Në kontekstin shqiptar, çështja e imunitetit parlamentar duhet të shihet në kuadrin më të gjerë të konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe të besimit të qytetarëve në institucionet publike. Neni 73 pika 1, 2, 3 dhe 4, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(f. 14)*, nuk krijon një papërgjegjshmëri të përfaqësuesit në parlament (deputetit). Ai bën të dallueshme mbrojtjen e mendimeve dhe votave në ushtrimin e funksionit dhe mbrojtjen procedurale nga forma të ndryshme të ndërhyrjes në lirinë personale. Kjo diferencë duhet të ruhet, sepse imuniteti procedural nuk duhet të interpretohet si një pengesë absolute ndaj drejtësisë. Nëse ekziston dyshimi për një vepër që nuk ka lidhje me ushtrimin e mandatit, *parimi i përgjegjësisë ligjore* duhet të mbetet në fuqi, ndërsa procedura e veçantë duhet të funksionojë si garanci kundër abuzimit dhe jo si instrument për shmangien e përgjegjësisë. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon imunitete në disa nene: për deputetin (*neni 73, f.14*), për Presidentin *(neni 90, pika 1, f.18)*, për imunitetin e deputetit si anëtar i Këshillit të Ministrave *(neni 103, pika 3, f.20)*, imunitet funksional të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të gjykatave të tjera, me përjashtim të interesit personal ose keqdashjes *(nenet 126 f.25, 137, f.29)*, si dhe imunitetin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit *(neni 165, pika 2, f. 41)*. Ndryshimet e vitit 2012 e kufizuan imunitetin e përgjithshëm nga ndjekja penale për deputetët, gjyqtarët dhe zyrtarët e lartë *(OSCE Presence in Albania, 2012)*. Në kuadrin e rregullimit të imunitetit parlamentar në Shqipëri, neni 73, pika 2 e Kushtetutës përcakton se kërkohet autorizimi paraprak i Kuvendit për arrestimin, heqjen e lirisë në çfarëdolloj forme, si dhe për kontrollin personal ose të banesës së deputetit. Pas reformës kushtetuese, autorizimi i detyrueshëm për nisjen e hetimit penal u shfuqizua. Ky interpretim u konfirmua nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë dhe u analizua gjerësisht nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në çështjen *Frroku kundër Shqipërisë* (*GJEDNJ, 2018, pika 6-7)*. Nga

pikëpamja doktrinore, imuniteti i deputetit shihet si një përjashtim legjitim nga e drejta e juridike, i cili ka për qëllim mbrojtjen e autonomisë institucionale, duke evidentuar njëkohësisht evolucionin historik të këtij neni që nga miratimi i tij në vitin 1998. Për një analizë më të zgjeruar dhe krahasuese të këtij koncepti brenda literaturës juridike në gjuhën shqipe, vlen të konsultohet studimi i realizuar nga profesori Arsim Bajrami. (2021, f. 112- 115). Në rrafshin ligjor, rëndësi kanë Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë (*përfshirë masat e sigurimit personal, si ndalimi i daljes jashtë shtetit dhe pezullimi i ushtrimit të detyrës në nenet 233 f.130 dhe 242 f.133*), Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *(nenet 13 f.28 dhe 118 f.118)* dhe organi parlamentar përgjegjës për imunitetin, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Kjo dinamikë e kufizimit të imunitetit mori një shtysë vendimtare përmes Reformës në Drejtësi të vitit 2016 *(Ligjet nr. 76/2016, nr. 84/2016 dhe nr. 95/2016)*, e cila sanksionoi krijimin e strukturave të specializuara kundër korrupsionit dhe procesin e rivlerësimit kalimtar *(Kuvendi i Shqipërisë, 2016a, 2016b, 2016c)*. Vijimësia historike e këtyre reformave u konsolidua më tej përmes ligjit nr. 16/2022, i cili zgjati mandatin e organeve bazë të vetingut (KPK) deri në fund të vitit 2024, duke transferuar më pas çështjet e mbetura në janar 2025 pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Paralelisht, ndryshimet në ligjin nr. 95/2016 (përmes ligjit nr. 47/2021) fuqizuan llogaridhënien e brendshme dhe pavarësinë e SPAK-ut, ndërsa përditësimet e fundit ligjore të vitit 2026 rregulluan më tej statusin dhe integritetin financiar të magjistratëve. Ky evolucion dëshmon kalimin nga një imunitet absolut tradicional drejt një sistemi të racionalizuar kushtetues, ku mbrojtja e funksionit parlamentar ekziston në ekuilibër të plotë me parimin e llogaridhënies para ligjit

Kushtetuta e ndërton vetë urën me standardet evropiane. Neni 17 pika 2, parashikon që kufizimet e të drejtave nuk mund ta tejkalojnë atë që lejon KEDNJ-ja, ndërsa neni 122 u jep marrëveshjeve të ratifikuara përparësi ndaj ligjeve. Rrjedhimisht, jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi imunitetet (seksioni 6) nuk është thjesht orientim, por kriter interpretues i detyrueshëm për ligjvënësin dhe gjykatat dhe testi i seksionit 5 mund të lexohet si mjet për të aplikuar këtë standard.

Analiza e mësipërme tregon se problemi i imunitetit parlamentar nuk mund të zgjidhet vetëm duke zgjedhur midis dy pozicioneve ekstreme: imuniteti duhet të ruhet plotësisht ose imuniteti duhet të eliminohet. Eliminimi i plotë i imunitetit mund ta ekspozojë parlamentin ndaj presioneve politike, gjyqësore ose ekzekutive dhe mund të dobësojë pavarësinë e mandatit. Në anën tjetër, një imunitet i pakufizuar mund të dobësojë barazinë përpara ligjit dhe besimin e qytetarëve. Zgjidhja që del nga analiza është një model funksional dhe proporcional. Sipas Rawls, institucionet demokratike duhet të jenë të justifikueshme përpara qytetarëve. Ndërkohë Esposito, evidenton se mbrojtja nga detyrimi i përbashkët mund të krijojë një distancë nga vetë komuniteti që institucioni duhet të mbrojë. Prandaj, imuniteti parlamentar duhet të justifikohet në të njëjtën kohë në aspektin normativ, të së drejtës, politik, etik dhe social.

Përfundime dhe rekomandime

Ky artikull argumentoi se imuniteti parlamentar duhet të kuptohet si një garanci funksionale e demokracisë, dhe jo si privilegj personal i deputetit. Analiza e neneve të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë tregon se sistemi kushtetues shqiptar njeh forma të ndryshme mbrojtjeje parlamentare: papërgjegjshmërinë për mendimet dhe votat e lidhura me funksionin, si dhe mbrojtjen procedurale nga disa ndërhyrje në lirinë personale. Nga perspektiva e Rawlsit, legjitimiteti i këtyre mekanizmave varet nga aftësia për t'i justifikuar publikisht përpara qytetarëve të lirë dhe të barabartë. Nga perspektiva e Espositos, imuniteti përmban një paradoks të brendshëm: ai është një mekanizëm mbrojtës, por njëkohësisht nënkupton një përjashtim nga një detyrim i përbashkët. Nga ndërthurja e këtyre dy perspektivave del koncepti i propozuar në këtë artikull: *imuniteti i përgjegjshëm*. Imuniteti i përgjegjshëm duhet të përmbushë katër kritere themelore: funksionalitetin, proporcionalitetin, përgjegjësinë dhe reciprocitetin. Imuniteti nuk duhet të jetë privilegj i pushtetit; ai duhet të jetë garanci e funksionit. Dhe pikërisht këtu qëndron kufiri ndërmjet imunitetit që mbron demokracinë dhe imunitetit që mbron privilegjin.

Në dritën e analizës së mësipërme, mund të formulohen disa rekomandime normative për interpretimin dhe zbatimin e imunitetit parlamentar në Shqipëri.

Së pari, imuniteti duhet të interpretohet në mënyrë funksionale, duke e lidhur mbrojtjen me ushtrimin real të mandatit parlamentar.

Së dyti, çdo kufizim procedural duhet t'i nënshtrohet testit të proporcionalitetit, duke shmangur interpretimet që krijojnë mbrojtje më të gjerë sesa kërkohet nga qëllimi kushtetues.

Së treti, procedurat parlamentare lidhur me imunitetin duhet të karakterizohen nga transparenca, motivimi dhe standarde të qarta institucionale, në mënyrë që vendimmarrja të mos perceptohet si mbrojtje politike e individit.

Së katërti, duhet të ruhet dallimi ndërmjet papërgjegjshmërisë funksionale për fjalën dhe votën parlamentare dhe imunitetit procedural, pasi ato kanë qëllime dhe pasoja të ndryshme.

Së pesti, çdo reformë e ardhshme duhet të synojë një ekuilibër ndërmjet dy vlerave kushtetuese: pavarësisë së mandatit parlamentar dhe përgjegjësisë përpara ligjit.

Legjitimiteti i imunitetit parlamentar varet jo vetëm nga ekzistenca e tij në tekstin kushtetues, por edhe nga mënyra se si ai kuptohet dhe zbatohet në praktikë. Një institucion demokratik është i fortë jo kur mbron bartësit e pushtetit, por kur krijon mekanizma që mundësojnë njëkohësisht ushtrimin e lirë të pushtetit dhe përgjegjësinë për ushtrimin e tij.

Bibliografia

- A. v. the United Kingdom, App. No. 35373/97 (European Court of Human Rights, 17 December 2002).
- Agamben, G. (1995). *Homo sacer: Il potere sovrano e la nuda vita*. Einaudi; (1998). *Homo sacer: Sovereign power and bare life* (D. Heller-Roazen, Trans.). Stanford University Press.
- Ajana, B. (2021). Immunitarianism: Defence and sacrifice in the politics of Covid-19. *History and Philosophy of the Life Sciences*, 43(1), Article 25. doi.org
- Bajrami, A., Leskoviku, M., Elezi, Z., & Muçaj, F. (2021). *Imuniteti, aspekte krahasimore*.
- Bellamy, R. (2007). *Political constitutionalism*. Cambridge University Press.
- Dyzenhaus, D. (2006). *The constitution of law*. Cambridge University Press.
- Esposito, R. (2008). Bíos: Biopolitics and philosophy. University of Minnesota Press.

- Esposito, R. (2010). *Communitas: The origin and destiny of community*. Stanford University Press.
- Esposito, R. (2011). *Immunitas: The protection and negation of life.* Polity Press.
- European Court of Human Rights. (2025). Guide on Article 6 of the Convention: Right to a fair trial (civil limb). Council of Europe.
- European Commission. (2025). *Albania 2025 report*. europa.eu
- Foucault, M. (2008). *The birth of biopolitics*. Palgrave Macmillan.
- Fuller, L. L. (1964). *The morality of law*. Yale University Press.
- Gera, A. (2024). The immunity of the deputy... *Interdisciplinary Journal of Research and Development*, 11(1), 176. doi.org
- Gross, O., & Ní Aoláin, F. (2006). *Law in times of crisis*. Cambridge University Press.
- OSCE Presence in Albania. (2012). *Head of OSCE Presence welcomes restriction of MPs' and judges' immunities in Albania*.
- Postema, G. J. (2022). *Law's Rule: The Nature, Value, and Viability of the Rule of Law*. Oxford University Press.
- Rawls, J. (1999). *A theory of justice (Rev. ed*.). Harvard University Press.
- Rawls, J. (2001). *Drejtësia si paanshmëri: një riformulim*: Botim në shqip nga ISP, Dita 2000, Tiranë.
- Rawls, J. (2005). *Political liberalism (Expanded ed.)*. Columbia University Press.
- Riemann, M., Cerella, A., & Esposito, R. (2025). On the medicalisation of global politics... *Cambridge Review of International Affairs*. doi.org
- Schmitt, C. (2005). *Political theology*. University of Chicago Press.
- Syngelidis v. Greece, App. No. 24895/07 (European Court of Human Rights, 11 February 2010).
- Tamanaha, B. Z. (2004). *On the rule of law*. Cambridge University Press.
- Venice Commission. (1996). *Report on the regime of parliamentary immunity (CDL-INF(1996)007)*. Council of Europe.
- https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/kushtetuta.pdf